



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1321/3 Prot.

Tiranë, më 01/ 10/ 2019

V E N D I M

Nr. 131, Datë 01 / 10 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, mori në shqyrtim ankesën me nr.119, datë 25.09.2019, të Sh. M, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjes politike*”, “*gjendjes ekonomike*”, “*moshës*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Nga dokumentacioni dhe parashtimet e sjella nga subjekti ankues, rezulton se Sh. M ka qenë i emëruar Inspektor, me detyrë Oficer i Patrullës së Përgjithshme/Trupë Shërbimi, në Seksionin e

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Rendit Publik, pranë Komisarariatit të Policisë Kukës, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, deri më datë 13.06.2017³.

Nëpërmjet Urdhërit me nr.255/3, datë 09.06.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është liruar nga Policia e Shtetit, me motivacionin: *“Shkurtohet funksioni në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë”*.

Subjekti ankues pretendon se ky shkurtrim ka qenë jo real dhe i motivuar nga arsye të tjera, për të zëvendësuar atë me militantë politik. Sh. M shprehet se: *“Mbas lirim kam paraqitur dy herë kërkesë për të rifilluar punë, pasi janë shtuar funksione policore, për plotësimin e mungesave organike me gradë Inspektor”* dhe se, sipas parashikimit të nenit 49⁴, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, brenda dy viteve ka të drejtë të rikthehet në strukturat e Policisë së Shtetit. Në këtë kontekst, z.M shprehet se ka paraqitur një kërkesë për t’u rimarrë në punë, në muajin Prill të vitit 2018 pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për të cilën nuk ka marrë asnjë përgjigje. Në vijim të parashtrimeve të tij, ai citon se: *“Mbas një muaji kam takuar Drejtorin e Burimeve Njerëzore, z.N.R dhe sipas porosisë së tij kam bërë kërkesë me shkrim për t’u ripranuar në polici dhe ja kam dorëzuar në dorë z.N.R, në prezencë të z.Ll.P. Përgjigja zyrtare ka qenë negative, duke cituar se nuk kemi vende të lira, por në të vërtetë gjatë kësaj periudhe janë rimarrë në punë punonjës policie me gradën Inspektor në shumë Drejtori Vendore të Policisë. Në muajin Mars 2019, pasi mora dijeni për vende të lira pune, kam paraqitur përsëri kërkesë për rikthim në punë brenda afateve ligjore, pasi me datë 13.06.2019 më mbaronte afati ligjor për t’u rikthyer përfundimisht në profesionin tim si punonjës policie. Moshë aktuale e imja është 47 vjeç dhe nga data 13.06.2019 e më tutje nuk përfitoj as pensionin suplementar që më takon sipas ligjit në fuqi”*.

Ankuesi citon se: *“Nëpërmjet këtyre veprimeve antikushetuese dhe antiligjore po diskriminohet edhe familja ime financiarisht, pasi nuk mund të gjej argumenta për anëtarët e familjes sime për t’u shpjeguar se pse unë jam pa punë, ndërkohë që për përgatitjen time si profesionist kanë investuar edhe ata, përveç shtetit dhe shoqërisë”*.

³ Referuar shkresës me nr.100/1 prot., datë 19.09.2019 të Drejtorisë vendore të Policisë së Shtetit, z.M ka qenë punonjës policie në Policinë e Shtetit nga data 16.03.1998-12.06.2017.

⁴ *“1. Një person mund të rikthehet në polici vetëm nëse ai ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me strukturat e Policisë së Shtetit brenda 2 viteve të fundit dhe është liruar nga policia për shkurtrim të funksionit, në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë.*

2. Personi, që trajtohet me pension të parakohshëm suplementar ose pension të shërbimit, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, nuk rikthehet në polici”.

Në vijim ai shprehet se, drejtuesit aktualë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, janë urdhëruar politikisht për të liruar vende për militantët e partisë dhe për t'i punësuar ata “me urdhëra nga lart”, duke e diskriminuar atë nëpërmjet refuzimit të kërkesave të tij për rimarrjen në punë, duke i hequr kështu përgjithmonë të drejtën për t'u kthyer në punë në Policinë e Shtetit.

Në përfundim të ankesës së tij, subjekti ankues ka kërkuar, të rikthehet në punë, si dhe të ndëshkohen personat përgjegjës për diskriminimin ndaj tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentat e depozituara nga subjekti ankues pranë Zyrës së KMD-së, Komisioneri, konstaton se:

- Subjekti ankues është liruar nga Policia e Shtetit nëpërmjet Urdhërit nr.255/3, datë 09.06.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ka marrë dizeni për këtë fakt me datë 13.09.2017.
- Nëpërmjet shkresës me nr.1703 prot., datë 13.09.2019 të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, vërtetohet fakti se, Sh. M, ish-punonjës i Policisë së Shtetit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, është trajtuar me pagesë kalimtare, sipas parashikime ligjore, për periudhën kohore nga data 13.06.2017 – 12.06.2019.
- Nëpërmjet shkresës me nr.100/1 prot., datë 19.09.2019 “Kthim përgjigje” të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, drejtuar subjektit ankues, evidentohet fakti se kjo përgjigje është dërguar në vijim të kërkesës së tij, të datës 13.09.2019, duke i sqaruar se, si rezultat i lirimimit të tij nga Policia e Shtetit me motivacionin e shkurtimit të funksionit në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë, të drejtat administrative financiare

janë ndërprerë me datë 13.06.2017, dhe se bazuar në nenin 49⁵, të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, afati i fundit për rikthimin e tij ka qenë data 13.06.2019 dhe për këtë arsye ai nuk mund të rikthehet në Policinë e Shtetit.

- Subjekti ankues nuk i ka bashkëlidhur ankesës së tij pranë KMD-së asnjë akt/dokument tjetër shkresor që të provojë faktin se ai ka depozituar deri me datë 13.06.2019, pranë organeve përkatëse, kërkesën për rikthimin e tij në Policinë e Shtetit, sipas parashikimeve ligjore si më sipër cituar. Përkundrazi, referuar akteve bashkëlidhur ankesës, konstatohet se kërkesa e fundit shkresore që subjekti ankues i ka drejtuar Policisë Vendore të Policisë Kukës daton me 13.09.2019, pra jashtë afatit kohor të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 49 të të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa ç), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar....”*, ankesa e Sh. M, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se, nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/ç, nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së Sh. M, për shkak se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës.

⁵ Pikat pikat ½ të tij.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijoni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Robert GAJDA

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA

Fusha: Punësim

Shkaku: Bindje politike, mosha, gjendja ekonomike